



Permbledhje joteknike e aktivitetit

“Prodhim dhe amabalazhim I pijeve joalkolike”



Subjekti : “Roi Bogova” sh.p.k
Hartoi: “EKO-STUDIO-PROJEKT”sh.p.k
Administrator : Shkelzen MADANI



Tirane, 2019



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe "produkte" qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

" LINJE E PERPUNIMIT DHE AMBALAZHIMIT TE UJIT TE PIJSHEM"

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 " Per Mbrojtjen e Mjedisit"*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 "Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes"*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 "Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"*
- *Ligji nr. 10 266 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 'Per metodologjine e raportit te VNM'*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje*



subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

➤ **Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se**

Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jape nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti: ”Roi Bogova” shpk,eshte regjistruar prane QKB me Nr. NIPT L99123401E me date 23.05.2019 ky subjekt do te bej **Prodhim dhe ambalazhim te ujit te pijshem** ne godinen e cila eshte e ndertuar me pare, ky eshte nje aktivitet i ri dhe teknologjia qe do te perdore eshte bashkohore. Persa i perket ujit qe do te prodhohet dhe ambalazhohet do te merret nga burimi uJOR per te cilin subjekti eshte i pajisur me leje shfrytezimi te burimit uJOR Nr 222/1 date 21.03.2017, miratuar me Vendim te Keshillit te Basenit Ujore Seman nr.11 date 16.02.2017

Sa me siper ky subjekt kerkon te kryeje procedurat per pajisje me **Leje Mjedisit tipi B**, pas perfundimit te procedurave me Vendim per VNM paraprake Nr. 4820 date 04.10.2019

Pershkrimi i projektit

Vendndodhja

Fabrika ne te cilen « Roi Bogove » shpk do te bej përpunimin dhe ambalazhimine ujit ndodhet në Berat, Bogove Lagjia Novaj, Rruga e Malit, godina tek pasuria 331/1 zona kadastrale 2811.



Pamje e vendndodhjes



Kordinatat e objektit ne sistemin Gaus Kruger

X	Y
4428510.525	4493481.505
4428517.552	4493483.805
4428512.419	4493475.603
4428519.584	4493477.761

Kordinatat e shfrytezimit uhor :

X : 44 93 091

Y : 44 29 649

Z= 265m

Pershkrimi i aktivitetit

Fabrika e përpunimit dhe ambalazhimit të ujit « Roi Bogova » shpk eshte projektuar per nje kapacitet 6-10 tone ne dite, kapacitet ky i lidhur me impiantin.

Duke iu referuar edhe lejes per perdorim te burimit uhor nr 222/1 prot dt 21.03.2017 prurja mesatare dhe sasia e ujit qe do te jepet ne perdorim do te jete $Q=0.005 \text{ m}^3/\text{s}$.



Fabrika e përpunimit dhe ambalazhimit të ujit « Roi Bogova » shpk ndodhet në Bogovë, . Është investim i kompanisë Roi Bogova, e sapo ndërtuar, me materiale të cilësisë më të lartë dhe me një linjë përpunimi dhe ambalazhimi uji ultra moderne. Teknologjia që përdoret shfrytëzon teknologjinë e dopie filtrave për të përfitur ujë 99.9% të pastër, të sigurt dhe me çmim shumë ekonomik. Kjo teknologji e zgjedhur është tërësisht e automatizuar, është shumë komode në menaxhim, është ekonomike në konsumin e energjisë dhe fuqisë punëtore si dhe ka ndikim mjedisor pothuajse zero në ujë, ajër, tokë dhe mjedisin human. Gjithashtu vlen për tu përmendur fakti që në këtë lloj teknologjie uji nuk i humbet parametrat e tij, duke iu referuar dhe faktit që burimi ndodhet në zone malore dhe kemi ujë të pasur me vlera minerale. Me anë të kësaj teknologjie nga uji hiqen vetëm komponente të cilat mund të konsiderohen të rrezikshme.

Ndërtesa e fabrikës është e përbërë nga një zyrë, tualet, dhomë e punonjësve dhe magazine ku magazinohet uji përpara shitjes. Kësaj pjesë i shtohet edhe sipërfaqja e prodhimit prej 110 m². Ndërtesa është e shtruar e gjitha me pllakë jo të rresqitme nga brenda duke ruajtur kështu edhe sigurinë e punonjësve ndërsa konstruksioni i përdorur për ndërtimin e kësaj fabrike është metalik.

Ndërtesa ka dy hyrje për në ambientet e jashtme. Ambienti i parë është reparti i prodhimit dhe ambalazhimit të ujit të pishen. Lenda e parë që në rastin konkret është uji vjen me anë të tubacioneve për tu futur me pas në cisternen pritese. Nga cisterna pritese uji kalon në fazën e trajtimit ku bëhet me dopio filter, metode kjo efektive në drejtime të shumta ku me kryesorja na jep një produkt final me vlera minerale, pa i ndryshuar shijen ujit dhe duke e lënë me komponentet jo të rrezikshme që del nga burimi. Pas trajtimit me dopio dhe boi filter uji kalon në cisternen mbajtëse. Pas këtij procesi, kalon në etapën e parafundit që është amabalazhimi. Amabalazhimi është i llojeve të ndryshme me kapacitetet përkatëse për çdo shishe uji. Pasi shishet mbushen në lidhjen që ky proces ka me cisternen mbajtëse i vendoset tapa hermetike për arsye të sigurisë ushqimore. Fundi i këtij procesi konsiston në vendosjen e etikës me logon e firmës bashkë me komponentet që uji ka, të matura këto nga një laborator të akredituar. Faza përfundimtare është ajo e magazinimit. Shishet vendosen në paletat për tu marrë me pas nga mjettet të cilat bëjnë të mundur shpërndarjen tek klientet që operatori disponon.

Procesi i përpunimit dhe ambalazhimit të ujit

1. Lenda e parë që në rastin konkret është ujë merret nga burim ujor, përkatësisht nga baseni ujor Sema me lejen që subjekti disponon. Uji depozitohet në një cisternë pritese për të kaluar me pas në etapën e tjetër të trajtimit
2. Nga cisterna pritese me anë të një pompe uji kalon në procesin e trajtimit. Trajtimi bëhet me dopio dhe ultra filter, një metode kjo shumë efektive për të ruajtur parametrat e ujit pa ndryshuar komponentet karakteristike të ujit. Në këtë fazë bëhet e mundur heqja e komponenteve që mund të konsiderohen negative për shëndetin e njeriut, por pa i ndryshuar ujit origjinalitetin karakteristik, duke marrë parasysh që merret në një zonë me burime shumë të pastra ujore.
3. Pas trajtimit uji kalon në cisternen mbajtëse, por në këtë fazë ai është i trajtuar dhe totalisht i gatshëm për konsum njëzëror apo shitje. Me anë të një mekanizmi uji pas cisternes mbajtëse kalon në procesin e amabalazhimit. Procesi i largjes dhe dizinfektimit të bidonave



fillon me heqjen e tapave një përdorimësh nga bidoni. Bidoni futet në makinerinë e larjes automatike të jashtme ku realizohet larja me furça me detergjentë dhe më pas bëhet shpëlarja me ujë të bollshëm. Për bidonat që kanë nevojë për një pastrim më të kujdesshëm përdoret aparatura e pastrimit me avull, e cila e pastron dhe dizinfekton bidonin. Më tej bidonat kalojnë tek makineria e larjes nga brenda, ku bidonat lahen dhe dizinfektohen me ujë me ozon, gjë që siguron një higjienë 100% të sigurt. Hapi i radhës është ristacionimi i bidonave të larë, të cilët kontrollohen në mënyrë të imtësishme nga një staf i kualifikuar.

4. Me pas atyre u vihet tape hermetike e cila nuk lejon kontaktin ne ujit te trajtuar me mjedisin e jashtem, kusht ky per nje siguri sa me te larte ne produktin perfundimtar. Faza e fundit e ketij procesi eshte vendosja e logos me emrin e prodhuesit, ne te cilen te shkruhen edhe te gjithë komponentet qe ky uje permban.
5. Magazinimi eshte procesi ku kemi arritur feedback-un. Uji vendoset ne paleta dhe magazinohet ne ambientin qe eshte posacerisht per magazinim.
6. Procesi i finalizuar eshte shperndarja e tij ne tregun e kerkuar. Transporti behet me mjete te cilat disponon kompania.





Eshte bere nje monitorim paraprak i ujit qe do te prodhohet dhe imbotilohet nga subjekti Roi Bogova shpk ,nga Laborator i akredituar Eko StudioProjekt shpk me poshte gjendet raporti i testimi ne te cili jepet rezultati fiziko kimik.

Nr.	Komponente te matur	Të dhënat e matjes		Njesia	Standarti i Metodes
		Pikat e Marrjes se Kampioneve			
		Rezultati Mostra para perpunimit	Rezultati Mostra pas perpunimit		
1)	Shija	N	N		
2)	Aroma	N	N		
3)	Ngjyra	N	N	-	-
4)	Turbullira	N	N	-	S SH ISO 7027
5)	Temperatura e ujit	25	25	°C	SSH EN ISO7730
6)	Përqëndrimi i joneve të hidrogjenit	7.97	7.87	pH njësi	ISO 10523
7)	Përcjellshmëria	239	239	μS CM ⁻¹ NE 20° C	ISO 27888
8)	Klor i lire	0.05	0.02	mg/l	S SHISO 7393
9)	Magnez	0.1	0.1	mg/l	S SH 2639-4
10)	Alkaliniteti total (CaCO ₃)	133	132	mg/l	ISO 9963-1
11)	Amonium	0	0	mg/l	ISO 7150
12)	Nitrite (NO ₂)	<0.01	<0.01	mg/l	ISO 6777
13)	Azoti	0.23	0.22	mg/l	S SHISO 5663
14)	Nitrate (NO ₃)	1.02	0.98	mg/l	ISO 15705
15)	Fortësia	7.448	7.392	°dH	ISO 6059
16)	Kalçium	53.2	52.8	mg/l	S SH ISO 6058
17)	Zink	0.05	<0.02	mg/l	
18)	Baker	0.19	0.74	mg/l	
19)	NaCl	0.0825	0.033	mg/l	
20)	Amoniak	0	0	mg/l	

PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187 m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit Osum, para se ky të dalë në fushën e Myzeqesë, më e madhja e Shqipërisë. Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06"); gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

Cilesia e ajrit, temperature, reshjet atmosferike

Klima e rrethit është tipike mesdhetare, me temperaturë mesatare vjetore 15,9 gradë C. Temperatura mesatare e muajve më të ftohtë është 7,2 gradë C dhe ajo e muajve më të nxehtë



28,2 gradë C. Temperatura absolute më e ulët ka qenë –12,2 gradë C dhe ajo maksimale 47,1 gradë C.

Relievi

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455 m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, malit Tomorit (Lindje, 2417 m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1218 m) si edhe lugina e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Flora dhe fauna

Vendi ku kerkohet leja e shfrytëzimit është pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetëm pak shkurre të vogla barishte. Te gjitha llojet e bimeve, që rriten përreth objektit janë të karakterit lokal pa ndonjë veçori dalluese dhe që nuk gëzojnë ndonjë status të veçantë mbrojtjeje. Brenda zones së shfrytëzimit janë të zhvilluar në mënyrë të kufizuar shkurret dhe bimët lokale.

Lumenjte

Lumi i Osumit rrjedh përmes qytetit dhe jashtë tij, afër Urës Vajgurore, bashkohet me lumin e Devollit të dy sëbashku formojnë Semanin (gjatësia e tij brenda rrethit 32km). Një nga lumenjtë kryesorë të vendit. Ai paraqet interes për bujqësinë, energjitikën, hidrogeologjinë, ekologjinë dhe urbanistikën. Sipas treguesve hidrologjikë, për nga gjatësia rradhitet i 8-ti, për nga baseni ujëmbledhës i 10-ti, për nga prurja mesatare vjetore i 11-ti dhe për nga lartësia mesatare e rrjedhjes i 4-ti. Krijon rrjedhën e tij të plotë pranë Vithkuqit, vend që merret si pika e fillimit të lumit. Në basenin e Osumit veshja bimore (698 km katror) përbëhet nga pisha, bredhi, dushku e shkurre të tjera mesdhetare. Në zonën e Çorovodës e Skraparit krijon kanione vertikale shumë të bukura, me forma të ndryshme, me thellësi deri 150m e 15-20m të gjera. Osumi transporton në Seman 995 milionë metra kub ujë në vit, me prurje mesatare 32,5m kub sek (në Berat 25-26,9m kub sek). Sasia vjetore e prurjes së ngurtë 1,356 milionë m kub. Gjatësia e Osumit brenda rrethit është 51km.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)

Ky vleresim kryhet në baze të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vleresimin e Ndikimit në Mjedis” dhe kërkesave të VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për vleresimin e ndikimit në mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparesi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe



juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shkarkime ne uje

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nentokesore. Persa i perket ujrave te gjeneruara nga larja e shisheve ato do te bashkohen me ujrat sanitare te fabrikes si ujrat e gjeneruar nga perdorimi i tualeteve nga stafi qe do te punoje ne fabrike, pastrime te ndryshme te gjitha keto ujra do te shkarkojne ne sistemin e kanalizimeve te zones. Mund te themi se saia e ujrave qe do te gjenerohet nga larja e shisheve nuk eshte e larte ne menyre qe te mbingarkohet rrjeti i kanalizimeve te zones, gjithashtu nuk ka permbajtje ndotesish apo kimikatesh. Shkarkimet do te jene brenda normave te lejuara referuar Vendimit Nr.177, date 31.03.2005 “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesë.”

Emetimet ne ajer

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk do te kete. Duke iu referuar aktivitetit nuk kemi emetime pluhurash apo ndotesish ne ajer. Emetimet do te vijne vetem nga mjetet e transportit te cilat do te terheqin ujin e ambalazhuar per ta shperndare me pas ne pikat e tregtimit. Keto emetime do te jene te minimale pasi mjete e transportit do te jene te kolauduara konform legjislacionit ne fuqi.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurma do te gjenerohen nga procesi i punes ne fabrike, por keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune. Nuk do te gjenerohen vibrime te ndjeshme, vibrime minimale mund te gjenerohen si pasoje e kalimit te mjeteve te transportit te ujit te ambalazhuar. Vibrimet nuk do te jene te larta dhe ne kete menyre ato nuk do te demtojne habitatet ne afersi te rruges automobilistike.

Ndikimet ne flore dhe ne faun

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte. Drejtuesit e shoqerise do te shtojne gjelberimin rreth perimetrit te fabrikes duke ulur edhe ato pak ndikime totalisht te paperfillshme ne mjedis.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perditshem ne kete objekt pra nga stafi qe do te punoje ne fabrike, keto mbetje do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre etj. Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V. Mbetjet te cilat gjenerohen nga skarciteti ne process do te jene thujse te paperfillshme pasi bidonat 20 l qe perdoren jane me material te forte dhe jo njeperdorimshe pra nuk behet fryrja e tyre me ajer



si ne rastin e shisheve njeperdorimshe, pasi ne kete forme krijohen shishe nga skarciteti ne sasi te konsiderueshme. Duke qene se sasia nga skarciteti eshte e paperfillshme keto bidona do te grumbullohen ne ambientet e fabrikes derisa te grumbullohet nje sasi e konsiderueshme dhe ne kete rast subjekti do te lidhe kontrate me subjekte te cilat jane te pajisur me licenc per riciklimin e ketyre mbetjeve.

Mbetje te tjera si rezultat i zhvillimit te ketij aktiviteti nuk do te gjenerohen pasi pjeset e kembimit nga riparimi i mjeteveve transportit apo dhe gomat e perdorura do te lihen ne servisin ne te cilin subjekti ben riparimin e mjeteve te transportit. Ndersa mirembajtja e linjes se prodhimit dhe ambalazhimit te ujit do te behet nga kompania ne te cilen eshte blere linja e prodhimit e cila ka bere dhe montimin e saj dhe si rezultat dhe pjeset apo filtrat te cilat duhet te zevendesohen do te terhiqen nga kjo shoqeri.

Kodet te mbetjeve te gjeneruara nga konsumi i perditshem nga punojst sipas:

VendimitNr. 99, datë 18.2.2005 .Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve, do te jene:

Leter dhe karton- 20 01, Mbetje te biodegradueshme-20 01 08, Plastikate- 20 01 39.

Persa i perket mbetjeve te gjeneruara nga procesi teknologjik ato do te jene vetem nga skarciteti i bidonave gjate mbushjes.

Kodet te mbetjeve te gjeneruara nga skarciteti ne procesin teknologjik:

Plastikat- 20 01 39

Ndikimet ne peisazh

Zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti eshte zone urbane, ndertesa ne te cilen zhvillohet aktiviteti nuk do prish peisazhin e zones,nuk prek peisazh panoramik.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V pra mbetjet urbane te gjeneruara nga stafi.
- Duke qene se sasia nga skarciteti eshte e paperfillshme bidonat do te grumbullohen ne ambientet e fabrikes derisa te grumbullohet nje sasi e konsiderueshme dhe ne kete rast subjekti do te lidhe kontrate me subjekte te cilat jane te pajisur me licenc per riciklimin e ketyre mbetjeve.
- Do te respektohet ne menyre strikte zona e pare e mbrojtjes se pusit ne menyre qe te kemi uje sa me te paster dhe te sigurt per prodhim dhe ambalazhim.subjekti ka bere izolim te plote te grykes se pusit nga siperfaqja dhe ka bere dhe rrethimin e tij.



- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime qe te shqetesojne faunen ne afersi te rruges.
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
 - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuarresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
 - Largimin e materialeve te ndezshme nga ambientet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
 - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
 - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
 - Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuarese si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidrante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.
- Persa i perket ujrave te gjeneruara nga larja e shisheve ato do te bashkohen me ujrat sanitare te fabrikes si ujrat e gjeneruar nga perdorimi i tualeteve nga stafi qe do te punoje ne fabrike, pastrime te ndryshme te gjitha keto ujra do te shkarkojne ne sistemin e kanalizimeve te zones. Mund te themi se saia e ujrave qe do te gjenerohet nga larja e shisheve nuk eshte e larte ne menyre qe te mbingarkohet rrjeti i kanalizimeve te zones, gjithashtu nuk ka permbajtje ndotesish apo kimikatesh. Shkarkimet do te jene brenda normave te lejuara referuar Vendimit Nr.177, date 31.03.2005 “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese.”